

 <b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova Republic of Kosova	<b>DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS</b>		 <b>Komuna e Istogut</b> Opstina Istog Municipality of Istog
	<b>Nr. 11-47/20</b>	<b>Dt.13.05.2020</b>	

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 18, Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 neni 21,22,44 dhe 84 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), neni 17 pika d/, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit administrativ të MMPH -së nr. 06/2017 të dt 23.05.2017 për shqyrtimin e kërkesës për Kushtet e ndërtimit dhe Lejës së ndërtimit si dhe duke vendosur sipas kërkesës me nr. 11-351-9787 të datës 12.03.2020, kompania **“GRANIT” SH.P.K.** me pronar Ismet Loshi nga Istogu, për lëshimin e Lejes ndërtimore për ndërtimin e objektit shumë banesor me etazhitet S+P+6+KT të Planit Rregullues Urban të Istogut, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, në procedurë administrative, merr këtë:

### VENDIM

#### LEJE PËR NDËRTIMIN E BANESËS SHUMË BANESORE & AFARISTE S+P+6+KT

<b>Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:</b>			
Emri:	kompania <b>“GRANIT” SH.P.K.</b> nga Istogu		
Adresa:	rr. <b>“Fadil Ferati”</b> Istog		
Telefoni:	██████████	Emaili:	

Emri i Projektit:	NDËRTESE SHUMË BANESORE & AFARISTE S+P+6+KT <b>“BLLOKU A dhe E”</b>		
Emri i Projektuesve:	1. Arkitektura – Vizark Sh.p.k. 2. Statika – A&H Studio Sh.p.k. 3. ElektriKa – Call – Home Elektronics Sh.p.k 4. Hidrostaika – Hidro Design Sh.p.k.		
Co. projektuese:	Studio projektuese <b>“VIZARK”SH.P.K.</b> rr. <b>“Agim Ramadani”</b> Prishtinë		
Telefoni:	██████████	Emaili:	

#### **Për punët ndërtimore në vijim:**

**Adresa:** Qasja ekzistuese në parcelë kadastrale është përmes rrugës ekzistuese **“Fadil Ferati”** gjegjësisht parcela nr.01920-0 ZK Istog

Zona(t) Kadastrale: Istog	Nr. i parcelave kadastrale: Nr. P-70806020-01920-0	GPS Koordinatat: x-7458047.350 y-4738207.101
------------------------------	---	---

<b>Lloji i ndërtimit të propozuar:</b>	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
<b>Kategoria e ndërtimeve të propozuara:</b>	
Kategoria I <input type="checkbox"/>	Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>
<b>Përdorimi i propozuar:</b>	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Përshkrimi: LEJE PËR NDËRTIMIN E BANESËS SHUMË BANESORE & AFARISTE S+P+6+KT "BLOKU A dhe E"	

Me këtë vendim, "GRANIT" SH.P.K. nga Istogu i Lejohet ndërtimi sipas dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor ndërtimi objektit afarist-banesor në kuadër të Bllokut Urban, Blloku II –B06 me KNN 50% konkretisht sipas certifikatës me nr. 688/2020 në parcelën kadastrale nr. 01920-0 të datës 11.03.2020 në përpjesë 1:640 në Zonën Kadastrale Istog

**Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
  - informata mbi Lejen Ndërtimore
  - informatat mbi projektuesin
  - informata mbi kontraktuesin
  - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
  - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
  - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
  - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e

licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
  - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
  - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
  - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

## Arsyetim

Aplikuesi investitor kompania "GRANIT" SH.P.K. nga Istogu, me kërkesë për Leje ndërtimi 11-351-9787 të datës 12.03.2020 ka kërkuar nga DPUM, lëshimin e Lejes ndërtimore për ndërtimin e objektit shumë banesor me etazhitet S+P+6+KT "Blloku A dhe E" të Planit Rregullues Urban të Istogut, në lokacionin e përshkruar në paragrafin 1. Të dispozitivit të vendimit të lejës ndërtimore.

DPUM pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të kërkesës bazë, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr. 5/L-031 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

### Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Dëshmi të pronësisë dhe dokumentacioni personal i fotokopjuar
- Kushtet Ndërtimore (nuk ka prezentuar)
- Vendimi për Pëlqim Mjedisor (është paisur-vendimi+elaborati)
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri (është paisur- vendimi+elaborati)
- Elaborati Gjeomekanik (nuk ka prezentuar)
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e II-rë
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera

**Shtojcë:** Situacioni i kompleksit me pozicionim të objektit, dispozita urbanistike e pozicionimit të objektit me kordinata, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

**Udhëzim juridik:** Pala e pa knaqur me këtë vendim, përmes kësaj drejtorie, me ankesë mund ti drejtohet MMPH në Prishtinë brenda afatit prej 30 ditësh. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të do të përcillet te organi epror – MMPH.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, kësaj Drejtorie, Drejtorisë për inspektim, Drejtorisë së kadastrit, Drejtorisë së financave, Qendrës për shërbime me qytetar.

### DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS NË ISTOGUT,

Planer Urban  
ark. Rrustem Gashi i.d



DREJTOR,  
Besart Dreshaj ecc. dip

